



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ 2022

**“PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 711, DATË 29.10.2014 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR
ADMINISTRIMIN DHE FUNKSIONIMIN E VARREZAVE NË TERRITORIN E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës, 2, të nenit 3/d, të ligjit nr. 9220, datë 15.4.2004, “Për administrimin e shërbimit të varrimit”, të ndryshuar”, me propozimin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

Në Rregulloren për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 711, datë 29.10.2014 “Për miratimin e Rregullores “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 3, shtohet pika 22, me përmbajtje si më poshtë:

“22. “Shtëpi funerale” është ambienti i padukshëm nga jashtë, i cili shërben si shtëpi pritje për kryerjen e ritualeve të lamtumirës dhe riteve të tjera në nderim të personave të vdekur.”.

2. Në nenin 36, riformulohet fjalia e parë e pikës 2 dhe shtohet pika 5, me përmbajtje si më poshtë:

a) “2. Agjencitë e shërbimit funeral licencohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për ushtrimin e aktivitetit të shërbimit funeral dhe ofrimin e shërbimit për shtëpi funerale, në drejtim të: ...”

b) “5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore parashikojnë kriteret dhe kushtet që Agjencitë e shërbimit funeral duhet të plotësojnë për ushtrimin e aktivitetit në lidhje me kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore.”

3. Në nenin 39, ndryshohet pika 3 dhe shtohet pika 5 me përmbajtje si më poshtë:

a) “3. Agjencitë dhe shtëpitë funerale duhet të zhvillojnë aktivitetin, si: plotësimi i formaliteteve, shitja e artikujve të varrimit dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me funeralin, brenda ambienteve të miratuara dhe që janë jo të dukshëm nga jashtë.

b) “5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kontrollojnë agjencitë e shërbimit funeral dhe shtëpitë funerale, për plotësimin dhe respektimin e kushteve dhe kritereve për ushtrimin e aktivitetit të tyre, të parashikuara në këtë vendim dhe në rregulla të tjera të vendosura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.”.

KREU II

1. Agjencitë të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, licencohen automatikisht nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. Në rast se Agjencitë nuk plotësojnë kriteret dhe kushtet për licencimin dhe ushtrimin e aktivitetit të tyre sipas këtij vendimi dhe rregullave të tjera të vendosura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, Agjencitë duhet t'i plotësojnë kriteret dhe kushtet e vendosura brenda 6 (gjashtë) muajve nga miratimi i rregullave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

3. Nëse pas afatit 6 (gjashtë) mujor nga data e miratimit të rregullave të vendosura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, Agjencitë nuk i plotësojnë kriteret dhe kushtet e vendosura, ato nuk licencohen.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

E D I R A M A

Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë
Belinda Balluku